



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pronuar - Pritëno Më/Dana 29.09.2022 Vitina			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednost
01-110/05-	1062		

Zy. Kryetarit



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

VENDIM

për plotësim ndryshimin e vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik me numër të protokollit 01-110/05-790 të datës 01.08.2022

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për plotësim ndryshimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik

- Objekti me njësisë kadastrale P-70101007-02507-0-21-3-1-0, në sipërfaqe prej 65 m², e cila gjendet në objektin e QKMF-së në Viti, zona kadastrale në Viti, Komuna e Vitisë.

Neni 2

Pronat në fjalë të cekura në neni 1 të këtij vendimi do të jepen në shfrytëzim me qera me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik për nevojat e veta që do ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore, që do të ndikojnë në punësim, me të cilën do të përfitojnë qytetarët dhe vet komuna (përfitimi material – qiraja).

Neni 3

Me këtë vendim për plotësim ndryshimin e vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik me numër protokollit 01-110/05-790, të datës 01.08.2022, ndryshohet kohëzgjatja e qirasë nga 5 vite në 13 vite, për shkak të disa ankesave nga të interesuarit për marrjen e këtij objekti me qera, me arsyetimin se afati i dhënies me qera është shumë i shkurt dhe objekti kërkon investim.

Neni 4

Procedurat për dhënie e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër, në kohëzgjatje prej trembëdhjetë vite (13) viteve, realizohet përmes ankandit publik, afati kohorë për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës – vendimi është afatshkurtër.

Neni 5

Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të Komunës dhe përfituesit, marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejtë të shkëputjes së kontratës edhe para afatit, nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria e Financave e Komunës së Vitisë.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit, drejtorive;
- Anëtarëve të komisionit;
- MAPL-së; dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI
Bekim Azizi

